



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.153/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Ymer Hoxha, anëtarë me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2.000,00 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 09.10.2017, me të cilën pretendon se Kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik LVV, Shpend Ahmeti, pretendohet se ka shkelur rregullën zgjedhore 13/2013 neni 5.2 duke përfshirë fëmijë në fushatë zgjedhore. Më konkretisht në postimin e tij, postuar me dt.09.10.2017, rreth orës 09:00, në faqen e tij të facebook-ut, janë përfshirë fëmijë. Postimi ka përmbajtje politike që ndërlikohet me fushatën zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të datës 10.10.2017, theksoj se menjëherë pasi që ka pranuar urdhrin nga PZAP-ja, ka ndërmarr masat përmirësuese lidhur me këtë çështje dhe ka larguar fotografën e publikuar në facebook, po ashtu ka theksuar se i ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij. Andaj LVV ka ndërmarr të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet lokale. Gjithashtu, LVV ka theksuar se fotoja është bërë gjatë tubimit të mbajtur në ndonjë nga lagjet e Prishtinës dhe ajo është publikuar në rrjetin social të kandidatit për kryetar të Prishtinës, Shpend Ahmeti, nga persona të cilët e menaxhojnë facebook-un e tij, ndërsa personat të cilët e menaxhojnë rrjetin social të kandidatit në fjalë, për shkak të intensitetit të lartë të punës kanë bërë një gabim të tillë.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur 4 fotografi ku shihet se është larguar fotografia nga rrjeti social facebook.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Shpend Ahmeti, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik LVV, ka vendosur fotografi me fëmijë në llogarinë e tij Facebook, që ka të bëjë me fushatë zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton se: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LVV, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr fotografimin nga rrjeti social facebook, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr.153/2017 më datë 12.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.